



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Shkurt 2021

Nr: 46

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj

Kërkues: Levizja Socialiste për Integrim

Ndaj: z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Baza ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 17, 18, 19, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoi relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, shqyrtoi parashtrimet e kallëzuesit, dhe të përfaqësuesit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:



I.

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë raportuar disa denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, i cili në llogarinë e tij personale në Facebook, ka publikuar disa foto dhe video me qytetarë të ndryshëm duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore. Kallëzimet e paraqitura nga kallëzuesi ruhen në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Kallëzimet e bëra në ndërfaqe/ portal deri me datën 18.1.2021 për këtë subjekt janë si vijon:

1. Denoncimi i raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 353 ora 19:27, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se:
“Më datë 30.12.2020 në faqen zyrtare të Panorama Online, është publikuar lajmi i zhvillimit të një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e dy familjeve në Zall-Herr. Lidhja e informacionit : <http://www.panorama.com.al/dy-familje-ne-zall-herr-hyjne-ne-shtepi-te-re-veliaj-jemi-perballur-cdo-vit-me-fatkeqesi-por-gjithmone-jemi-ringritur/>”.
2. Denoncimi i raportuar më datë 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 574, ora 18:05 pretendohet se: “Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, më datë 25.12.2020 ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, disa foto të një veprimtarie ku së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë z. Edi Rama dhe Administratorin e Njësisë Administrative Zall-Herr, z. Arben Maloku në banesën e rindërtuar pas tërmetit të një familjeje”. Lidhja për aktivitetin:
<https://www.facebook.com/ErionVeliaj/photos/a.10159091604826926/10159091588721926>
3. Denoncimi i raportuar më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 578 ora 18:07, pretendohet se: “Më datë 27.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, ka publikuar në faqen e tij Facebook-ut, aktivitete së bashku me Ministrin e Shtetit për Rindërtimin, z. Arben Ahmetaj dhe Prefektin e Tiranës, z. Toni Gogu, në banesat e rindërtuar pas tërmetit të disa familjeve në Pezë”
Lidhja për aktivitetin <https://www.facebook.com/38316716925/videos/190738619415813/>.
4. Denoncimi i raportuar më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 570 ora 18:03, pretendohet se: “Më datë 27.12.2020 është zhvilluar një aktivitet nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama, publikuar në faqen e tij Facebook-ut, <https://www.facebook.com/èatch/?v=238147354359789>, aktivitete

në banesat e rindërtuara nga tërmeti të disa familjeve”.

5. Denoncimi i raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 362 ora 20:23, pretendohet se: *“Më datë 29.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, veprimtari në banesat si dhe ka dorëzuar dokumentat e shtëpive të rindërtuara nga tërmeti të disa familjeve, në Farkë”.* Lidhja per aktivitetin e z. Erion Veliaj <https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/304649480974017>,
6. Denoncimi i raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 360 ora 20:02, pretendohet se: *“Më datë 29.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, një veprimtari në familjen Deliu”.*
7. Denoncimi i raportuar më datë 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 580 ora 18:08 pretendohet se: *Më datë 30.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, ku së bashku me deputetin e Kuvendit të Shqipërisë z. Xhemal Qefaliaj ka zhvilluar veprimtari në banesat e rindërtuara pas tërmetit të dy familjeve në Zall-Herr”.* Lidhja e aktivitetit te kryetarit te bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj <https://www.facebook.com/38316716925/videos/389871772082149/>
8. Denoncimi i raportuar më datë 05.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 406 ora 14:28 pretendohet se: *“Më datë 31.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, <https://fb.watch/2OXmNruo6K/> një veprimtari gjatë së cilës ka vizituar shtëpinë e rindërtuar pas tërmetit të një qytetari në Baldushk”.*
9. Denoncimi i raportuar më datë 05.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 404 ora 14:20 pretendohet se: *“Më datë 05.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj ka publikuar në faqen e tij të Facebook-ut, veprimtari në banesat e rindërtuara si dhe ka dorëzuar çelësin dhe dokumentat e shtëpisë pas tërmetit tre familjeve në Baldushk”.*
10. Denoncimi i raportuar më datë 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 562 ora 17:57 pretendohet se: *“Më datë 07.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, ka postuar në faqen e tij Facebook-ut, veprimtari gjatë të cilës së bashku me deputetin e Kuvendit të Shqipërisë z. Sadi Vorpsi dhe Kryetari i Njësisë Administrative Farkë, z. Adrian Tufa në banesat e rindërtuara nga tërmeti të dy familjeve në Farkë”.* Lidhja e aktivitetit te z. Erion Veliaj <https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/1702414226598463>,

Sipas denoncuesit *“Këto veprimtari të tij bien ndesh me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, shkronja "d", dhe paragrafi 1, dhe për një rast nënparagrafi 1.3 e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilët parashikojnë si veprimtari të ndaluar mbështetjen dhe promovimin e*

objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore si dhe veprimtari të ndaluara janë edhe ato veprimtari që përfshijnë shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike.

Referuar kompetencave sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos shqyrtimin bashkërisht të denoncimeve pasi konstaton se kanë të njëjtin subjekt dhe objekt, në të cilat pretendohet shkelje të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1.1, shkronja “d”, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator për kallëzimet si vijon:

1. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 353 dt. 30.12.2020
2. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 360 dt. 30.12.2020
3. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 362 dt. 30.12.2020
4. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 404 dt. 5.1.2021
5. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 406 dt. 5.1.2021
6. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 562 dt. 9.1.2021
7. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 570 dt. 9.1.2021
8. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 574 dt. 9.1.2021
9. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 578 dt. 9.1.2021
10. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 580 dt. 9.1.2021

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Levizja Socialiste për Integrim përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7 të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me

zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Neni 92 pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

Neni 64 i ligjit nr. 139/2015 “Për organet e vetëqeverisjes vendore” përcakton kompetencat e kryetarit të bashkisë përfshirë kompetencën për sigurimin e plotësimit të të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësues i saj në marrdhëniet me të tretët.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj z. Erion Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative që vijnë në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 e 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/ 2020 të Komisionit Rregullator në KQZ dhe për të cilat parashikohet sanksion administrativ.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa pika 5 e këtij vendimi sanksionon se subjektet raportuese mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar. Momenti i aksesit në ndërfaqe, momenti i dërgimit të e-mail-it ose momenti i mbërritjes së postës në zyrat e Komisionerit

përbën momentin kohor në të cilin fillojnë të ecin afatet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e raportimit, sipas këtij vendimi.

Me shkresën nr. 2616 Prot., datë, 24.12.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në respektim të kërkesave të këtij vendimi i ka kërkuar Bashkisë Tiranë caktimin e personit të kontaktit me qëllim raportimin e veprimtarive publike.

Në bazë të kërkesës verbale kjo llogari është krijuar me datë 07.01.2021, ndërsa konfirmimi i personit të kontaktit është dërguar me shkresën nr. 5402 prot, datë 02.02.2021 të Bashkisë Tiranë, administruar në KQZ me shkresën nr. 827 prot, datë 03.02.2021.

Nga datat 30.12.2020 deri me datë 10.01.2021, subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim ka kallëzuar në ndërfaqjen e KQZ-së dedikuar aktiviteteve të ndaluara, disa aktivitete të njoftuara medias/transmetuara, të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, të pasqyruara dhe në faqen e tij të facebook, të referuara si në vijim:

- 1) Sipas denoncimit të raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr . 353 ora 19:27, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e dy familjeve në Zall-Herr.
 - a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
 - b) Me shkresën nr. 413 prot. datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
 - i) Me shkresën nr 19/1 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. datë 25.01.2021, Top Channel informon se aktiviteti është transmetuar në edicionin e lajmeve të datës 30.12.2020 të edicionit informativ të orës 15:00 në minutën 16:10.
 - ii) Me shkresën nr. 6 prot., datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a. (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it, dërguar elektronikisht në adresën elektronike të kësaj media. Aktiviteti është publikuar me datë 30.12.2020.
 - iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.

- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 Prot., datë 26.01.02021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo te ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
 - ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar cdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.
 - v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shoqërive tregtare.
 - vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, për këtë aktivitet, Bashkia Tiranë informon se lajmi është publikuar në gazetën Panorama online me informacionin se dy familje në Zall Herr të dëmtuara nga tërmeti kanë marrë celsat e shtëpive.
- 2) Sipas denoncimit të raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 360 ora 20:02, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga kryetari i bashkisë Tiranë me datë 29.12.2020 në familjen Deliu.

- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
- i) Me shkresën nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. datë 25.01.2021, Top Channel informon se aktiviteti është transmetuar në edicionin e lajmeve të datës 29.12.2020 të edicionit informativ të orës 15:00 në minutën 25:30.
- ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it, dërguar në adresën elektronike të kësaj media në datën 30.12.2020.
- iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit të Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 Prot., datë 26.01.2021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
- ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë

rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

- iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar cdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.
 - v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shoqërive tregtare.
 - vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, Bashkia Tiranë informon se për këtë aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të Facebook-ut të kryetarit të Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj, fotoalbum në banesën e re të Muhamet Deliut.
- 3) Sipas denoncimit të raportuar më datë 30.12.2020 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 362 ora 20:23, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet veprimtaria publike e kryetarit të pretendohet publikimi i një veprimtarie ku janë dorëzuar dokumente të shtëpive të rindërtuara nga tërmeti të disa familjeve në Farkë.
- i) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezulton i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
 - ii) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
 - iii) Referuar shkresës nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. Datë 25.01.2021, nga Top Channel ku informon për aktivitetet e transmetuara prej saj të kryetarit të bashkisë z. Erion Veliaj, rezulton se ky aktivitet është publikuar nga kjo media së bashku me veprimtarinë e denoncuar me nr ID 360.
 - iv) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së

komunikimit të Bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar elektronikisht në adresën elektronike të kësaj media, në datën 29.12.2020.

- v) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- vi) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. Datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- b) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- c) Me shkresën nr. 2686/1 Prot., datë 26.01.02021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
 - ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar cdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut. Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shooqërive tregtare.
 - v) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, Bashkia Tiranë, informon se ky aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të Facebook-ut të kryetarit të Bashkisë, video e postuar në datën

29.12.2020. Në këtë informacion i cili identifikohet si aktiviteti 4 i aneksit sqarues/informues, kryetari i bashkisë Tiranë ka shpërndarë dokumente të pronësisë

- 4) Sipas denoncimit të raportuar më datë 05.01. 2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 404 ora 14:20 në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet një veprimtari e kryetarit të bashkisë Tiranë në tre familje në në Baldushk.
- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezulton i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot. datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
- i) Me shkresën nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. datë 25.01.2021, Top Channel informon se aktiviteti është transmetuar ne edicionin e lajmeve të datës 05.01.2021 të edicionit informativ të ores 15:00 në minutën 26:23.
- ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit te Bashkise Tirane janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar në adresën elektronike të kësaj media. Për këtë aktivitet Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) është njoftuar për publikim me e-mailin nr protokollu 413/1 Aneksi B në datën 05.01.2021.
- iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 Prot, datë 26.01.02021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo te ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore,

me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, c'ka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.

- ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar cdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.
 - v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shoqërive tregtare.
 - vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, Bashkia Tiranë informon se për këtë aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të Facebook-ut të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, video e postuar në datën 05.01.2021 “vizitë në tre familje në Baldushk”.
- 5) Sipas denoncimit të raportuar më datë 05.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 406 ora 14:28 , në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet veprimtaria e z. Erion Veliaj ne familjen e nje qytetari në *Baldushk*.
- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezulton i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
 - b) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
 - i) Me shkresën nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. datë 25.01.2021, Top Channel informon se aktiviteti eshte transmetuar ne edicionin e lajmeve të datës 31.12.2020 të edicionit informativ të ores 15:00 në minutën 26.10

- ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar në adresën elektronike të kësaj media. Për këtë aktivitet Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) është njoftuar për publikim me emailin nr protokolli 4131/1 Aneksi E, në datën 31.12.2021.
 - iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
 - iv) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. Datë 6.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 Prot, datë 26.01.02021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
 - ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar çdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.

- v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënave të kontaktit të bashkië Tiranë/ institucioneve në varësi/ shooqërive tregtare.
- vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, Bashkia Tiranë informon se për këtë aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të Facebook-ut të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj, video e postuar në datën 31.12.2020.
- 6) Sipas denoncimit të raportuar më datë 07.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 562, në ndërfaqjen e KQZ-së ne te cilën denoncohet aktiviteti i kryetarit të bashkisë Tiranë Z. Erion Veliaj së bashku me deputetin e Kuvendit të Shqipërisë Z. Sadi Vorpsi dhe Kryetarin e Njësisë Administrative Farkë Z. Adrian Tufa, në banesat e rindërtuara pas tërmetit në Farkë.
- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot.. datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen më të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
- i) Me shkresën nr. 19/1 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot., datë 25.01.2021, televizioni Top Channel informon se aktiviteti është transmetuar në edicionin e lajmeve të datës 07.01.2021 të edicionit informativ të orës 15:00, në minutën 30:29.
- ii) Me shkresën nr. 110/3 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot., datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- iii) Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 prot., datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot., datë 19.01.2021, KQZ i ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 prot., datë 26.01.2021, protokolluar nga KQZ me nr. 441/1 prot., datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka

nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.

- ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter public dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore paradatës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar çdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.
 - v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shoqërive tregtare.
 - vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, për këtë aktivitet, Bashkia Tiranë informon se bëhet fjalë për videon e publikuar më datë 07.01.2021, për vizitën në dy shtëpi të rindërtuara në Farkë.
- 7) Sipas denoncimit të raportuar më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 570, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet zhvillimi i nje aktiviteti nga z. Veliaj se bashku me Kryeministrin e Shqipërisë Z. Rama në banesat e rindërtuara pas tërmetit, në disa familje.
- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
 - b) Me shkresën nr. 413 prot.. datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
 - i) Referuar shkresës nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. Datë 25.01.2021, nga Top Channel ku informon për aktivitetet e transmetuara prej saj të kryetarit të bashkisë z. Erion Veliaj, rezultoi se ky aktivitet nuk është publikuar nga kjo media në asnjë prej programacioneve të veta.
 - ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e

Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar elektronikisht në adresën elektronike të kësaj media. Për këtë aktivitet referuar shkresës së Shoqërisë Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama), rezuton se nuk ka njoftim me email, nga zyra e shtypit e Bashkisë Tiranë.

- iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot, datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 Prot. Datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot. datë 19.01.2021, KQZ ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 Prot, datë 26.01.02021, protokolluar nga KQZ me nr 441/1 prot, datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
 - i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
 - ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter publik dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar cdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.

- v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënave të kontaktit të Bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shoqërive tregtare
- vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, Bashkia Tiranë informon se ky postim nuk gjendet as në këtë datë dhe as në asnjë datë të tjetër, në Facebook-un e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.
- 8) Sipas denoncimit të raportuar më datë 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 574, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet zhvillimi me datë 25.12.2020 i një aktiviteti nga Kryetari i Tiranë, Z. Erion Veliaj, së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, Z. Edi Rama dhe Administratorin e Njesisë Administrative Zall-Herr, Z. Arben Maloku, në banesën e rindërtuar pas tërmetit tek një familje.
- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen me të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
- i) Me shkresën nr. 19/1 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot., datë 25.01.2021, televizioni Top Channel informon se ky aktivitet nuk është transmetuar.
- ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar elektronikisht në adresën elektronike të kësaj media. Për këtë aktivitet referuar shkresës së Shoqërisë Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama), rezultoi se nuk ka njoftim me email, nga zyra e shtypit e Bashkisë Tiranë.
- iii) Me shkresën nr. 110/3 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot., datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se ka transmetuar një aktivitet të Kryeministrit Z. Edi Rama së bashku me Kryetarin e Bashkisë Z. Erion Veliaj në Zall-Herr, në datën 24 Dhjetor 2020. Ky transmetim është bërë si aktivitet i Kryeministrit, në kanal RTSH 24 dhe përmes transmetimit direkt nga faqja personale në Facebook e tij. Transmetimi i këtij aktiviteti është bërë direkt për sa kohë ka zgjatur dhe kronika nuk është transmetuar më tej. Për këtë arsye, RTSH nuk ka pamje të ruajtura të këtij aktiviteti.

- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 prot., datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot., datë 19.01.2021, KQZ i ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 prot., datë 26.01.2021, protokolluar nga KQZ me nr. 441/1 prot., datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
 - ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter public dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore paradatës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
 - iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar çdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i bashkisë Tiranë.
 - iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesëmarrjen e publikut.
 - v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shooqërive tregtare.
 - vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, për këtë aktivitet, Bashkia Tiranë informon se video e zhvilluar në kuadër të mbarëvajtjes së procesit të rindërtimit është zhvilluar dhe transmetuar në 24.12.2020. Fotoalbumi është postuar në datë 25.12.2020.
- 9) Sipas denoncimit të raportuar më date 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 578, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet zhvillimi i nje aktiviteti me date 27.12.2020, nga

Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj së bashku me Ministrin e Shtetit për Rindërtim Z. Arben Ahmetaj dhe Prefektin e Tiranës Z. Tonin Gogu, në banesat e rindërtuara pas tërmetit të disa familjeve në Pezë.

- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen më të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
 - i) Me shkresën nr. 19/1 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot., datë 25.01.2021, Top Channel informon se aktiviteti është transmetuar në edicionin e lajmeve të datës 28.12.2020 të edicionit informativ të orës 15:00, në minutën 30:05.
 - ii) Me shkresën nr. 6 prot., datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot., datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, dhe si dhe në email të dërguara në adresën e kësaj media. Aktiviteti është publikuar më datë 28.12.2020.
 - iii) Me shkresën nr. 110/3 prot., datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot., datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
 - iv) Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 prot., datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot., datë 19.01.2021, KQZ i ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- d) Me shkresën nr. 2686/1 prot., datë 26.01.2021, protokolluar nga KQZ me nr. 441/1 prot., datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
 - i) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka

nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.

- ii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter public dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore paradatës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
- iii) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar çdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
- iv) Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesëmarrjen e publikut.
- v) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shooqërive tregtare.
- vi) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, , për këtë aktivitet, Bashkia Tiranë informon se videoja është publikuar në datën 28.07.2020 dhe nuk ka asnjë postim për një aktivitet të tillë gjatë datës 27.12.2020.

10) Sipas denoncimit të raportuar më date 09.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 580, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet zhvillimi i nje aktiviteti publik me datë 30.12.2020, nga Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. Erion Veliaj së bashku me deputetin e Kuvendit të Shqipërisë Z. Xhemal Qefaliaj, tek dy familje në Zall-Herr.

- a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet nuk rezultoi i raportuar në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9 të Komisionit Rregullator nga institucionet publike subjekt i këtij vendimi.
- b) Me shkresën nr. 413 prot., datë 10.01.2021, KQZ i është drejtuar disa mediave publike dhe private me shtrirjen më të madhe gjeografike duke i kërkuar informacion nëse ka gjetur raportim/ informim të publikut aktiviteti i denoncuar dhe nëse ka pasur ftesë nga Bashkia Tiranë për transmetimin e tij/ tyre.
- i) Referuar shkresës nr 19/1 prot. Datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 573 prot. datë 25.01.2021, nga Top Channel ku informon për aktivitetet e transmetuara prej saj të kryetarit të bashkisë z. Erion Veliaj, rezultoi se ky aktivitet nuk është publikuar nga kjo media në asnjë prej programacioneve të tyre.

- ii) Me shkresën nr. 6 prot. datë 20.01.2021, administruar në KQZ me nr. 413/1 prot, datë 25.01.2021, Shoqëria Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama) informon se aktivitetet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë publikuar në bazë të njoftimeve zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë, të bëra nëpërmjet email-it ,dërguar elektronikisht në adresën elektronike të kësaj media. Për këtë aktivitet referuar shkresës së Shoqërisë Panorama Group sh.a (Gazeta Panorama), rezulton se nuk ka njoftim me email, nga zyra e shtypit e Bashkisë Tiranë.
- iii) Me shkresën nr. 110/3 prot datë 22.01.2021, administruar në KQZ me nr. 548 prot. datë 25.01.2021, RTSH ka informuar se nuk ka transmetuar këtë aktivitet.
- iv) Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 25.01.2021, administruar në KQZ me nr. 601 prot., datë 26.01.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ATSH, pohon se informacioni i publikuar në faqen zyrtare www.ata.gov.al, është vënë në dispozicion në rrugë elektronike nga Zyra e Shtypit e Bashkisë Tiranë.
- c) Me shkresën nr. 441 prot., datë 19.01.2021, KQZ i ka kërkuar informacion Bashkisë Tiranë për aktivitetin në fjalë.
- i) Me shkresën nr. 2686/1 prot., datë 26.01.2021, protokolluar nga KQZ me nr. 441/1 prot., datë 27.01.2021, Bashkia Tiranë ka deklaruar se:
- ii) Referuar Aktit Normativ nr. 9/2019, neni 10, autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, me qëllim garantimin e donatorëve dhe të qytetarëve se nuk do të ketë abuzime me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve, Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike cdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, cka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi.
- iii) Bashkia Tiranë sqaron se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari/ aktivitet me karakter public dhe promovues pasi nuk janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore paradatës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/ zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
- iv) Bashkia Tiranë në funksion të garantimit të transparencës së veprimtarive publike në zbatim të vendimit 9/2020 të KQZ-së ka raportuar çdo aktivitet të zhvilluar nga kryetari i bashkisë Tiranë.

- v) Sipas bashkisë Tiranë në asnjë rast këto inagurime banesash individuale nuk kanë qenë të hapura për pjesmarrjen e publikut.
- vi) Bashkia Tiranë ju ka vendosur në dispozicion të dhënat e personave të kontaktit të bashkisë Tiranë/ institucioneve në varësi/ shooqërive tregtare.
- vii) Në informacionin e detajuar aneks i shkresës, për këtë aktivitet, Bashkia Tiranë informon se bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të postuar më datë 30.12.2020 në Panorama Online.

Me datë 04.02.2021 ora 17:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të kërkesave të nenit 88 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” zhvilloi një seancë dëgjimore me palët në këtë proces administrativ.

Për palën e kallëzuar në seancë u paraqitën z. Eridian Salianji dhe z. Alban Dokushi, të autorizuar me prokurën nr. 1563 rep, nr. Kol 615 datë 04.02.2021 dhe z. Alban Dokushi i përfaqësuar me autorizimin nr. 5643/1 prot. datë 04.02.2021.

Për palën kallëzuese u paraqit në seancë përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim z. Altin Kaziaj.

Përfaqësuesit e palës së kallëzuar z. Salianji dhe z. Dokushi sqaruan se veprimtaritë e z. Veliaj janë zhvilluar me fonde të vëna në dispozicion në buxhetin e shtetit përpara datës 24.12.2020 që korrespondon me datën e hyrjes në fuqi të vendimit 9/2020 dhe periudhën e ndalimit të aktiviteteve. Përfaqësuesit pretenduan se nuk kishin në dispozicion kohën e nevojshme teknikisht për të realizuar raportimet.

Përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim deklaroi se veprimet e kryetarit të bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj bien ndesh me nenin 179 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 10 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Në seancat e datave 5.02.2021 ora 12:00 dhe datës 09.02.2021 ora 13:30 u administruan nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve provat:

1. **Vendim nr. 51, datë 14.05.2020** për “Një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2020” të ndryshuar;
2. **Vendim nr. 22, datë 17.03.2020** për “Një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor

afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të bashksië së Tiranës për vitin 2020” të ndryshuar;

3. **Vendim nr. 46. datë 29004.2020** për “Një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të bashksië së Tiranës për vitin 2020” të ndryshuar.

4. **Prapsimet ndaj provave të subjektit kërkues Lëvizjes Socialiste për Integrim**, përmes përfaqësuesit të saj ligjor, z. Kaziaj janë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

III.

Analiza ligjore

Referuar gjetjeve sa më sipër, pyetjet që shtrohen për t’u adresuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve janë si më poshtë:

- a) A përbëjnë këto veprimtari veprimtari publike për tu raportuar?
- b) Nëse po, kur fillon afati për raportimin e tyre nga bashkia Tiranë?
- c) A kanë këto aktivitete përmbajtje të veprimtarive të ndaluara në kuptim të nenit 3 pika 1.3 të Vendimit 9/2020?

Në vlerësim të provave dhe faktet e sipërpërmenduar, Komisioneri çmon se:

- a) Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në KQZ dalë në zbatim të kërkesave të neneve 91 dhe 92 të Ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe është publikuar në faqen e internetit në KQZ me datë 26.12.2020.
- b) Me shkresën nr. 2616 datë 24.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka dërguar kërkesën për caktimin e personit përgjegjës për bashkinë Tiranë dhe institucionet e varësisë në respektim dhe zbatim të kërkesave të vendimit nr. 9 /2020 të KQZ.
- c) Nga KQZ edhe pse pa shkresë zyrtarë, por me kërkesë verbale të tyre, bashkisë Tiranë i është mundësuar aksesit teknik në ndërfaqen e KQZ-së me datën 07.01.2021.

Në analizë të pyetjeve të mësipërme rezulton se:

- a) Bashkia Tiranë ka administruar kërkesën me datë 28.12.2020 dhe rrjedhimisht ka marrë dëgjimin për aktin e miratuar. Referuar dispozitave të nenit 104 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit.

- b) Bashkisë Tiranë referuar kërkesave të nenit 92, pikat 1, 2 e 3, të Kodit Zgjedhor, dhe të Vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, i lind detyrimi të raportojë aktivitetet me karakter publik me qëllim promovimin e tyre duke filluar nga data 29.12.2020.
- c) Përsa më sipër KQZ nuk do të procedojë për hetimin e administrativ të mosraportimit të aktiviteteve të ndodhura gjatë periudhës 24.12.2020 deri me datë 28.12.2020, dhe respektivisht denoncimet e gjeneruara nga sistemi me nr. ID 570, 574, 578 datë 09.01.2021, për shkak se është provuar që këto aktivitete janë zhvilluar dhe publikuar me datë 24.12.2020 deri me datë 28.12.2020. Komisioneri, hetoi për këto veprimtari vetëm për sa ato përbëjnë veprimtari të ndaluar, pavarësisht detyrimit për raportim.
- d) Gjithashtu, KQZ nuk do të procedojë për hetimin e administrativ të denoncimit të gjeneruar nga sistemi me nr. ID 562 për arsye se rezulton të jetë aktivitet i raportuar në ndërfaqe.

Për veprimtaritë e denoncuara me nr. ID 353, 360, 362, datë 30.12.2020, për aktivitetet e denoncuara me nr. ID 404, 406 datë 05.01.2021, për veprimtarinë e denoncuara me nr. ID 580, datë 09.01.2021, rezulton që këto veprimtari janë zhvilluar përgjatë periudhës 29.12.2020 deri me datë 07.01.2021. Të gjitha këto veprimtari rezultojnë të pa raportuara në ndërfaqe dhe janë publikuar në media (Gazeta Panorama, ATSH dhe Top Channel) dhe z. Erion Veliaj, në cilësinë e drejtuesit administrativ të bashkisë Tiranë duhej të merrte masa dhe të raportonte zhvillimin e këtyre aktiviteteve me postë elektronike, apo postë standarte sipas përcaktimeve të nenit 4 pika 5 të vendimit 9/2020.

Rezulton e provuar se strukturat administrative të marrëdhënieve me publikun/ komunikimit të bashkisë Tiranë kanë njoftuar organet e medias për aktivitet objekt denoncimi ose kanë vënë në dispozicion të medias në rrugë elektronike informacionin për veprimtaritë e denoncuara.

Referuar dispozitave të nenit 2 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe nenit 92 pika 1, të Kodit Zgjedhor përcaktohet detyrimi i institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore përfshirë edhe subjektin e denoncuar, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Aktivitetet e denoncuar si aktivitete publike të kryera nga institucioni i Bashkisë Tiranë, i konsideruar si subjekt raportues sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, duhej të ishin raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së.

Referuar nenit 3 paragrafi “b” i vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.

Nga përgjigjet e marra nga mediat, lidhur me raportimin prej tyre të këtij aktiviteti, njoftimi për aktivitetet është realizuar përmes zyrës së shtypit të bashkisë. Kështu, edhe nëse në momentin real të zhvillimit të aktivitetit, nuk ka pasur prezent asnjë media, dërgimi i materialit të përgatitur prej vetë Bashkisë së Tiranës, përmes zyrës së shtypit të këtij institucioni, secilës prej tyre, vërteton qëllimin e informimit të publikut nëpërmjet medias për veprimtaritë e zhvilluara.

Për sa më sipër pretendimi i bashkisë se ky aktivitet nuk ka pasur qëllim informimin e publikut ashtu sikurse përcakton vendimi nr. 9 /2020 i KQZ-së, por transparencën e tij si dhe përmbushjen e detyrimit të përcaktuar nga Akti Normativ 9/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për të bërë publik çdo të ardhur donacion apo shpenzim për procesin e rindërtimit, nuk gjendet i bazuar dhe i mbështetur në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit 9/2020 të KQZ-së.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se zhvillimi i këtyre aktiviteteve të ndaluara janë kryer në kundërshtim me nenin 3, pika 1.1, germa “d” të Vendimit 9/2020, referuar edhe deklarimeve të administruara me shkresën nr. 2686/1 prot. datë 26.01.2021 të Bashkisë Tiranë rezultojnë e paprovuar nga denoncuesi që fondet e vëna në dispozicion për ndërtimin e këtyre objekteve janë vënë në dispozicion në periudhën e ndaluar nga neni 91 dhe 92 i Kodit Zgjedhor dhe Vendimi 9/2020 i KQZ-së.

Pretendimet e Bashkisë Tiranë dërguar me shkresën nr. 5402/1 prot datë 05.02.2021 se në asnjë rast këto veprimtari nuk kanë qenë të hapura për publikun apo të medias me argumentimin se dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias që ta konsiderojë veprimtarinë publike dhe se facebook-u nuk ka marrë pjesë në veprimtarinë e kryetarit të bashkisë Tiranë sepse facebook-u nuk është media që “merr pjesë” për arsye se i mungon karakteri publik që kërkon germa “a” e pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit 9/2020, është i pambështur në fakte dhe rrethana të ligjit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të theksojë se neni 92 pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton qartë kriterin e përcaktimit të veprimtarisë publike. Në kuptim të kësaj norme, formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut rreth këtyre veprimtarive, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Pra referuar kësaj dispozite ligjore nuk është kriter pjesëmarrja e medias fizikisht për ta konsideruar atë veprimtari me karakter publik, por qëllimi informues ose aksesit që mund të ketë media ndaj aktivitetit të zhvilluar.

Madje ligji ka përcaktuar si kusht edhe qëllimin në vetvete të aktivitetit nëse ai ka pasur si qëllim informimin e publikut duke e vendosur aktivitetin në agjendën informuese të organit publik.

Kryetari i bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj është përfaqësuesi i një institucioni publik vendor, të cilit Kodi Zgjedhor i ngarkon detyrën e raportimi në KQZ për çdo veprimtari publike, në zbatim të pikës 2 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Ne aktivitetin e denoncuar nga LSI me nr. ID 360 e 362 të zhvilluar me datë 30.12.2020 ne njoftim është përmendur fakti i dorëzimit të çelësave dhe dokumentet e pronësisë së shtëpisë. Bashkia Tiranë në shkresën 2686/1 prot., datë 26.01.2021, në aneksin për aktivitetin nr. 4 të datës 29.12.2020 që i korrespondon aktivitetit të denoncuar me nr. ID 360 e 362 ka pohuar se anëtarët e 3 familjeve morën në duar dokumentet e pronësisë së banesës së saporindërtuar nga kryetari i bashkisë Tiranë. Z. Erion Veliaj.

Neni 3, pika 1.3, shkronja “b” e vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndalon shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën” në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Në rastin e kallëzuar nga subjekti LSI, pohohet nga vetë subjekti i kallëzuar, dorëzimi i dokumenteve të pronësisë. Ky moment përbën veprimtari të ndaluar pasi veprimtaria ka përmbushur të dyja kushtet kumulative të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020 (“...Shpërndarja në veprimtari publike të certifikatave të pronësisë sipas legjislacionit...”):

- a) karakteri publik/ informues;
- b) dorëzimi i certifikatave të pronësisë.

Karakterit publik/ informues vërtetohet nga komunikimet e zyrës së shtypit të bashkisë Tiranë të cilët dëshmojnë informimin e medias. Dorëzimi i certifikatave të pronësisë, pohohet nga vetë subjekti i kallëzuar.

Përsa më sipër provohet se aktiviteti i datës 29.12.2020 pavarësisht faktit nëse duhej të ishte raportuar apo jo, përbën aktivitet të ndaluar nga vendimi 9/2020 i Komisionit Rregullator. Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj mban përgjegjësi administrative, si drejtues i Bashkisë Tiranë, ndaj të cilat Kodi Zgjedhor i ngarkon detyra.

IV.

Konkluzione

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, vlerëson se:

1. Veprimtaritë e denoncuara me nr. ID 353, 360, 362, 404, 406 dhe 580 të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, përbëjnë veprimtari publike për tu promovuar në kuptim të nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dhe të neneve 2, shkronja “b”, e 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Rezultoi e paprovuar në fakte dhe në prova që Bashkia Tiranë të ketë marrë masa aktive për të njoftuar në kohë KQZ-në me email apo me postë dhe pse në mungesë të kredencialeve për raportimin e aktiviteteve publike. Mosraportimi i tyre në KQZ ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Bashkisë Tiranë.
2. Dorëzimi i dokumenteve të pronësisë së shtëpive të rindërtuara, të pohuara nga Bashkia Tiranë në infomacionin shpjegues bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2686/1 datë 26.01.2021, përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1.3 shkronja “b” të vendimit nr. 9/2020, dhe ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Bashkisë Tiranë.
3. Inspektimi i shtëpive të rindërtuara dhe promovimi i tyre nuk përbën veprimtari të ndaluar për arsye se fondet janë vënë në dispozicion para datës 25.12.2020, siç provohet nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “f”, “dh” e “n” e 2, nenet 91, 92 e 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 17, 18, 19 e vijues të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, dhe në nenet 3 e 10, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator,

V E N D O S:

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike.
2. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.
3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI





Data: 9 Shkurt 2021
Nr. 46

Për shqyrtiminin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ndaj z. Erion Veliaj.